



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 54, datë 20.04.2021

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 2, TË VKB NR. 41, DATË 31.03.2021 “PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E DËMTUARA NGA PËRMBYTJET TË SHKAKTUARA NGA RRESHJET E DENDURA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE SUKTH, KATUND I RI, SI DHE NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.6, BASHKIA DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë Durrës nr. 60, datë 01.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e rënies të rreshjeve të datave 25-26 janar 2021 në territorin e Bashkisë Durrës”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë Durrës nr.122, datë 22.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e rënies të rreshjeve të datave 10-11 shkurt 2021 në territorin e Bashkisë Durrës” dhe sipas Relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile si dhe nga komisionet e vlerësimit, ngritur me Urdhërin nr. 60, datë 01.02.2021 dhe Urdhërin nr.122, datë 22.02.2021, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e ndryshimit të pikës 2, të VKB nr. 41, datë 31.03.2021 “Për akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmytjet të shkaktuara nga rreshjet e dendura në Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri, si dhe Njësia Administrative nr.6, Bashkia Durrës, si më poshtë vijon:
2. Ky fond do të mbulohet nga fondi i emergjencës i Bashkisë Durrës, viti 2021, i ndarë si më poshtë:
 - Vlera prej 14’300’073 lekë, nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale për mbrojtjen civile për vitin 2021.
 - Diferenca prej 32’713’127 lekë, nga të ardhurat e veta të Bashkisë Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 20.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. ~~287~~ / prot.



Durrës, më 20. 04 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 54 datë 20.04.2021 Për miratimin e ndryshimit të pikës 2 të VKB Nr. 41 datë 31.03.2021 “Për akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga rreshjet e dendura në Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri si dhe Njësia Administrative Nr. 6, Bashkia Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

